



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 348 Vendimi**

**Tiranë, më 17.2.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Kryesuese
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, sot, më 17.2.2021, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT: Z. Gjergji Rudi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe neni Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2021, është njohur me vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme nr. \*\*\*, datë 25.6.2018, “Për mbarimin e emërimit të magjistratit”, të z. Gjergji Rudi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për shkak të mbushjes së moshës për pension.
2. Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi më 8.10.2016.

3. Më 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit dhe ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare më 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin e formularëve ka përfunduar në datën 31 janar 2017.
4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për z. Gjergji Rudi, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ka filluar menjëherë me:
  - a. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c. Plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
5. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.2.2020, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka vendosur ngritjen e trupit gjykues për shqyrtimin e dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit, të pashortuar, për një periudhë 1-vjeçare. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim, përbëhet nga Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Brunilda Bekteshi.

## **II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

6. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”
7. Pika 3 e nenit 179/b i Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke iu nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.
8. Trupi gjykues ka konstatuar se z. Gjergji Rudi ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mirditë dhe me dekretin nr. 5282, datë 30.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.
9. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.6.2018, Prokurori i Përgjithshëm, ka deklaruar mbarimin e emërimit të z. Gjergji Rudi, për shkak të mbushjes së moshës për pension. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021 Gjykata Administrative e Apelit informon se nuk është ushtruar ankim ndaj vendimit të Prokurorit të Përgjithshëm.
10. Neni 160, pika 2, germa “dh” e ligjit nr. 96/2016, parashikon se: “*Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj, duke vërtetuar mbarimin e emërimit në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit*”.

11. Trupi gjykues çmon se objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi, është bërë i pamundur, referuar nenit 95: “*Pamundësia në objekt apo qëllim*”, të Kodit Procedurës Administrative, i cili specifikon se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.
12. Ligji nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 4, parashikon se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar në dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 64, pika 1, germa “c” të ligjit nr. 96/2016,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për **z. Gjergji Rudi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 17.2.2021

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Valbona SANXHAKTARI**  
Kryesuese

**Olsi KOMICI**  
Anëtar

**Brunilda BEKTESHI**  
Relatore

*Denisa Kosta*  
Sekretare gjyqësore